



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:079790

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06790299

C.nr.550/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me bashkëpunëtorin profesional Senad Telaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.S.P.dhe R.M.që të dy mësimdhënës në SHFMU "G.T." në fshatin A.-Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Zahir Hamza, avokat në Prishtinë, me adresë rr."Garibaldi", nr.13/8 Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, me objekt kontesti kompensimi i ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, vlera e kontestit 4,272.00 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 03.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar**, kërkesëpadia e paditësve R.S.P.dhe R.M.që të dy mësimdhënës në SHFMU "G.T." në fshatin A.-Komuna e Malishevës dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, t'i kompensoj paditësit si vijon:

Paditëses R.S.P.:

- Në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 31.12.2022, apo për 23 muaj (për çdo muaj shumën e mbetur prej 42.45 Euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit-licencimit, të shkallës prej 35% të pagës bazë-204.60 Euro), t'ia paguaj paditëses së lartcekur shumën e përgjithshme prej 976.35 Euro (nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë Euro e tridhjetë e pesë cent).

Paditësit R.M.:

- Në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 31.12.2022, apo për 23 muaj (për çdo muaj shumën e mbetur prej 89.00 Euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit, të shkallës prej 35% të pagës bazë-421.00 Euro), t'ia paguaj paditësit të lartcekur shumën e përgjithshme prej 2,047.00 Euro (dymijë e katërdhjetë e shtatë Euro).

- Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 26.02.2024 (datë e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

- II. REFUZHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, përkatësisht shuma prej 1,159.65 Euro (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro e gjashtëdhjetë e pesë cent) për paditësen e parë R.S.P.dhe shuma prej 89.00 Euro (tetëdhjetë e nëntë Euro) për paditësin e dytë R.M., në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, **si e pabazuar**.
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve pjesërisht t'ua kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 196.00 Euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit, ndërsa **REFUZHET** kërkesa e paditësve për kompensimin e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar.

A r s y e t i m

Paditësit R.S.P.dhe R.M.që të dy mësimdhënës në SHFMU "G.T." në fshatin A.-Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit të tyre Zahir Hamza, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë me datën 26.02.2024, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit, duke theksuar se paditësja e parë R.S.P.është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse e lëndëve Kimi, Fizikë, mjedis jetësor dhe Biologji në shkollat SHFMU "G.T." në fshatin A.-Komuna e Malishevës, në SHMP "L.G." në fshatin K.-Komuna e Malishevës dhe në gjimnazin "H.B." në Malishevë, ndërsa paditësi i dytë R.M.është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës i lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën SHFMU "G.T." në fshatin A.-Komuna e Malishevës. Kanë kërkuar që në emër të kualifikimit, paditëses së parë R.S.P.t'i paguhet diferenca në pagë në bazë të kualifikimit prej 35% nga datat 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2022, në shumën e përgjithshme prej 2,136.00 Euro, ndërsa paditësit të dytë R.M.t'i paguhet diferenca në pagë në bazë të kualifikimit prej 35% nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2022, në shumën e përgjithshme prej 2,136.00 Euro, duke kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësve, e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura Komuna e Malishevës, përmes së autorizuarit së saj Mujë Sahitaj-avokat publik i komunës, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 20.11.2024, ku ka theksuar se në këtë rast lidhur me pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore në kontratën kolektive, për faktin se në bazë të kontratës së mësimdhënësve kualifikimi u paguhet çdo mësimdhënësi që është paraqitur në kontratën e punës gradimi mbi pagën bazë. Tutje ka

theksuar se bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021, në veçanti në nenin 7 pika 1.3 të kësaj kontrate përcaktohet se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi dhe se të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% të pagës bazë, e ndër tjera ka shtuar se kjo kërkesëpadi është e paarsyeshme edhe për nga lartësia e shumës që është kërkuar. Poashtu sipas pretendimeve të të autorizuarit të së paditurës dispozitat e këtij neni të sipërcituar nuk kanë karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit dhe se nga kjo dispozitë shihet qartë se qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar dhe asesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate, ku në nenin 35, janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu që nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare të së paditurës: kompensimi për orët shtesë, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë të pranuar nga enti i statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar në nenin 7 të kësaj kontrate për shkak të mungesës dhe mos planifikimit të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se: “Pagat e punëtorëve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj kontrate, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim”, andaj me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara. Ka theksuar poashtu se lidhur me këtë padi të parashtruar nga ana e paditësve e njëjta ka arritur parashkrimin në bazë të nenit 352 dhe 353 par.1 të LMD-së dhe se padia e paditësve është paraqitur pas afatit ligjor në vitin 2024, pasi Kontrata Kolektive e vitit 2021 është shkëputur nga MASHTI më datë 22.11.2022. I ka propozuar gjykatës që padinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar sepse nuk ekziston asnjë bazë ligjore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Për paditësen e parë R.S.P.: Kontrata e punës nr.11/16 e datës 25.01.2021, diplomën e kualifikimit universitar nr.695, licencën e mësimdhënësit me nr.1027772 dhe listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa për paditësin e dytë R.M.shqyrtoi këto prova: Kontrata e punës nr.11/1078 e datës 27.09.2018, diplomën e kualifikimit universitar nr.778, licencën e mësimdhënësit me nr.100007771 dhe listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë

seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpapia e paditësve është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, si dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja e parë R.S.P. është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse e lëndëve Kimi, Fizikë, mjedis jetësor dhe Biologji në shkollat SHFMU “G.T.” në fshatin A.-Komuna e Malishevës, në SHMP “L.G.” në fshatin K.-Komuna e Malishevës dhe në gjimnazin “H.B.” në Malishevë, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e dytë e lëshuar nga Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Edukimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi i dytë R.M. është i punësuar tek e paditura si mësimdhënëse e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën SHFMU “G.T.” në fshatin A.-Komuna e Malishevës.

Nga diploma e kualifikimit universitar, vërtetohet fakti se: Paditësja e parë R.S.P. studimet e nivelit Master i ka mbaruar me datë 26 prill 2016 (diploma nr.695) në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë dhe ka marrë titullin Master i Shkencave të Kimisë. Poashtu nga licenca e mësimdhënësit vërtetohet fakti se paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 1027772. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 204.60 Euro (*Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën nga data 01.10.2021 e deri me datë 31.10.2021, vërtetohet fakti se paditësja R.S.P. i ka **10 orë punë në javë**, ashtu që sipas përlllogaritjes së kësaj liste ≈ 411.87 Euro paga bazë – 8.11 Euro shtesa për përvojë pune – 29.16 Euro shtesa e paguar për kualifikim – 170.00 Euro shtesa e kompensimit e paguar, ashtu që paga bazë del të jetë 204.60 Euro*) dhe në emër të kualifikimit me Bachelor për çdo muaj paditëses i është paguar shuma nga 26.19 Euro dhe kjo listë e pagave vërtetohet edhe me datën e lindjes që përputhet me diplomën dhe licencën e lartcekur, si dhe me numrin personal. Nga diploma e kualifikimit universitar, vërtetohet fakti se: Paditësi i dytë R.M. studimet e nivelit Master i ka mbaruar me datë 1 dhjetor 2020 (diploma nr.778) në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prishtinë dhe ka marrë titullin Master i Edukimit-Udhëheqja në Arsim. Poashtu nga licenca e mësimdhënësit vërtetohet fakti se paditësi ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100007981. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësi realizon pagë bazë në lartësi prej 421.00 Euro dhe në emër të kualifikimit me Bachelor për çdo muaj paditësit i është paguar shuma nga 58.32 Euro dhe kjo listë e pagave vërtetohet edhe me datën e lindjes që përputhet me diplomën dhe licencën e lartcekur, si dhe me numrin personal. Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”, provave të lartcekura gjykata ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që: *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimitdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se: *“Mësimitdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që: *“Për kërkesat e mësimitdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*. Pasi nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja e parë R.S.P. është në marrëdhënie pune tek e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare me titull Master i Shkencave të Kimisë dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës së karrierës, poashtu nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësi i dytë R.M. është në marrëdhënie pune tek e paditura, se i njëjti ka diplomë universitare me titull Master i Edukimit-Udhëheqja në Arsim dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës së karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditësve iu takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

Gjykata vlerësoj se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses së parë R.S.P. pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Master, pasi është paguar në shumën prej 29.16 Euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagave), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 71.61 Euro, (35% e pagës bazë-204.60 Euro), me ç'rast i ka mbetur borxh paditëses për çdo muaj në shumën prej 42.45 Euro dhe atë për 23 muaj x 42.45 Euro = 976.35 Euro, konkretisht për periudhën kohore nga data 01.02.2021 e deri më 31.12.2022 (Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën nga data 01.10.2021 e deri me datë 31.10.2021, vërtetohet fakti se paditësja R.S.P. i ka **10 orë punë në javë**, ashtu që sipas përlllogaritjes së kësaj liste ≈ 411.87 Euro paga bazë – 8.11 Euro shtesa për përvojë pune – 29.16 Euro shtesa e paguar për kualifikim – 170.00 Euro shtesa e kompensimit e paguar, ashtu që paga bazë del të jetë 204.60 Euro), përkatësisht 23 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca për çdo muaj nga 42.45 Euro, andaj gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke ia refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses si të pabazuar.

Gjykata vlerësoj se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit të dytë R.M. pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Bachelor, pasi është paguar në shumën prej 58.32 Euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagave), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 Euro, (35% e pagës bazë 421.00 Euro), me ç'rast i ka mbetur borxh paditësit për çdo

muaj në shumën prej 89.00 Euro dhe atë për 23 muaj x 89.00 Euro = 2,047.00 Euro, konkretisht për periudhën kohore nga data 01.02.2021 e deri më 31.12.2022, përkatësisht 23 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca për çdo muaj nga 89.00 Euro.

Meqenëse nga parashtrësja e padisë u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, fakt ky që nuk u kontestua nga ana e të paditurës, dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit për kualifikim sepse sipas të njëjtës mësimdhënësit paguhet për çdo muaj për kualifikim, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, andaj gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit dhe atë për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2022, përkatësisht 23 muaj.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 26.02.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj paditësve.

Gjykata e ka vlerësuar pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore në kontratën kolektive pasi ky kompensim nuk është përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate, mirëpo këtë pretendim e refuzoj për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë, gjykata e vlerësoi se është pjesërisht i bazuar pretendimi i palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, shprehimisht theksohet që: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 26.02.2024, ndërsa kërkesa e tyre ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit-licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2021 deri më datën 31.01.2021, ndërsa paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë. Poashtu Gjykata pagën bazë të paditësve e

ka llogaritur duke u bazuar në listën e pagave. Andaj, mbi këtë gjykata e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket pikës II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjkata ka vlerësuar se nga sqarimet e dhëna si më lart, pjesa tjetër e kërkesëpadisë duhet refuzuar, ashtu që duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Gjkata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në numrin tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 156.00 Euro për përpilim padie (*Kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 Euro, për paditësin e dytë*) dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 40.00 Euro (*e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore*), ndërsa shpenzimet e procedurës kontestimore të kërkuara në shumë prej 208.00 Euro për përpilim padie për paditësin e dytë përtej shumës së aprovuar (*156.00 Euro*) u refuzua nga gjykata duke u bazuar nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës (*Kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 Euro, për paditësin e dytë*).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil
C.nr.550/2024, me datë 03.02.2025

G j y q t a r j a
Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.